

KËRKESË
Nr 478/2, datë 4.3.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Milot-Rrëshen” (shtesat për truall, objekte ndërtimi, kultura bujqësore dhe drufrutorë).

Subjekti kërkuar, i këtij objekti, është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogarit, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.03.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe për llogaritjen së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” i ndryshuar, për pronarët, sipas listave emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit truall, objekte ndërtimi, kultura bujqësore dhe drufrutorë.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 17 046 773 (shtatëmbëdhjetë milion e dyzet e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë.

**MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS**
Edmond Haxhinasto

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

Tabela 1

OBJEKTET QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR "MILOT-RRËSHEN"

NR	PRONARI			Z.Kad.	Tokë arë nr. i pasurisë	OBJEKTE NDËRTIMI		SHËNIME
	Emri	Atësia	Mbiemri			Lloji i Pasurisë	Sipas preventivit	
1	2	3	4	5	6	7	8	9
1	Gjok	Bib	Vokri	1601	55/14	Lokal	559890	Plotësim dokumentacioni
2	Aleksandër	Ndue	Biba	1601	151/2	Shtëpi banimi	1563537	Konfirmim ZVRPP
3	Dritan	Ndue	Biba	1601	151/1	Shtëpi banimi	1563537	Konfirmim ZVRPP
4	Geg	Ndue	Ndoka	1601	112/1	Shtëpi banimi	2078691	Konfirmim ZVRPP
5	Kol	Frrok	Malshi	1601	49/7	Shtëpi banimi	4127926	Plotësim dokumentacioni
6	Dila		Përlala	3244	13/42	Shtëpi banimi	1272030	Plotësim dokumentacioni
7	Donika	Dodë	Molla	2693	1/1-N3	Rezervuar dhe pus uji	648576	Plotësim dokumentacioni (K.Shitbleje)
	SHUMA						11814187	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE
Tabela 2

OBJEKTET QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR "MILOT-RRËSHEN"
PËR SIPËRFAQE TOKE (TRUALL)

NR	PRONARI			Zona Kadastr.	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërf. përgjith. m²	Truall			Konfirmime ZRPP
	Emri	Atësia	Mbiemri					Sip.e shpron. (m²)	Çmimi Lekë/m²	Vlera, lekë	
1	Pashke Ndue Zina Terezina Antoneta Nikolin Lule Margarita	Lekë Lekë Lekë Lekë Lekë Lekë Lekë	Gega Gega Gega Gega Gega Gega Gega	2693	1/116	truall	2346	2346	1330	3120180	Konf. ZVRPP
2	Bujar	Xhemal	Tafa		1/112	truall	700	133	1330	176890	Konf.ZVRPP
3	Aleksander	Ndue	Biba	1601	151/4	truall	300	190	767	145730	Konf.ZVRPP
SHUMA								2669		3442800	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONAREVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR " MILOT-RRËSHEN" PËR
KULTURAT DRUFRUTORE

Tabela 3

[illegible]